

**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"Investments & Business Solutions AL"**

## STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Investments & Business Solutions AL”

Në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, ligjit nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, ligjit nr.131/2015, datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, unë e nënshkruara:

- **Lediona Kamberi**, lindur më 08.04.1989 në Tepelenë dhe banuese në adresën: *Rruja “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Tiranë*, shtetase shqiptare, identifikuar me leternjoftimin me nr.personal I95408033J, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

në cilësinë e Ortakut të Vetëm, **sot më datë 2.10.2023**, ditë e Hënë, në Tiranë, miratoj statutin e shoqërisë **“Investments & Business Solutions AL”** SH.P.K., me përbajtje si vijon:

### NENI 1 ORTAKU I SHOQËRISË

Themeluesi i shoqërisë **“Investments & Business Solutions AL”**, me përgjegjësi të kufizuar, është ortaku i vetëm, shtetas:

- **Lediona Kamberi**, lindur më 08.04.1989 në Tepelenë dhe banuese në adresën: *Rruja “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Tiranë*, shtetase shqiptare, identifikuar me leternjoftimin me nr.personal I95408033J, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### NENI 2 FORMA LIGJORE

2.1 Shoqëria është e themeluar dhe e organizuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

2.2 Shoqëria mund të shndërrohet në formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.



## **NENI 3 BAZA LIGJORE**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë STATUT dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **NENI 4 KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon me datën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **NENI 5 SELIA E SHOQËRISË**

- 5.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruja "Tish Daija" Kompleksi Kika 2, Njësia Administrative Nr.5, Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me miratimin e organeve kompetente të shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të hapen këto degë.

## **NENI 6 EMRI & DOKUMENTET E SHOQËRISË**

- 6.1 Emri i Shoqërisë është "Investments & Business Solutions AL" SH.P.K.
- 6.2 Të gjitha shkresat, formularë, fatura, reklama, korrespondencia apo cdo dokument tjetër, nxjerrë nga shoqëria apo degët e zyrat e përfaqësimit pavarsisht nga mënyra e transmetimit që u drejtohen palëve të treta, do të përbajnë përvèc emrit të shoqërisë dhe të dhënat e mëposhtme:

- *numrin unik të identifikimit të subjektit,*
- *formën ligjore të shoqërisë,*
- *adresën e selisë,*
- *vlerën e kapitalit themeltar të regjistruar dhe vlerën e kapitalit të paguar,*
- *një shënim nëse Shoqëria është në likujdim e sipër (nëse aplikohet).*

## NENI 7 OBJEKTI

7.1 Objekti i veprimitarisë është:

- Ndërmjetësim në pasuri të paluajtshme (transaksione shitblerje, qëradhenie, etj),
- Menaxhim dhe administrim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë dhe të palëve të treta,
- Shërbime mirëmbatje & pastrimi të pasurive të paluajtshme,
- Dhënie me qëra/nën-qëra e pasurive të paluajtshme,
- Shërbime reklamimi dhe marketingu, analiza-studim tregu dhe vlerësime të pasurive të paluajtshme dhe jo vetëm,
- Agjent në sigurime,
- Shërbime të këshillimit/konsulencës financiare, ekonomike, tregtare, fiskale dhe manazheriale.
- Shërbime të mirëmbajtjes së kontabilitetit të njësive ekonomike dhe përgatitjes së raporteve financiare në funksion të Drejtimit.
- Shërbime të menaxhimit të projekteve, përgatitja e plan bizneseve të ndryshme, verifikimin e shpenzimeve.
- Përllogaritje pagash, asistencë në plotësimin e dokumentacionit për leje pune/leje qëndrimi për te huajt.

Shoqëria mund të kryejë cfarëdo veprimitari tjeter që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

7.2 Objekti i veprimitarisë mund të ndryshohet me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

## NENI 8 KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

8.1 Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri.

8.2 Kapitali themeltar i shoqërisë në datën e këtij STATUTI përbëhet nga **1 kuotë (pjesë), me vlerë 100 (njëqind) lekë. Kapitali themeltar është 100 % kontribut i ortakut të vetëm.** Kontributi i nënshkruar i kapitalit nuk është paguar.

8.3 Ortakët mund të vendosin për rritjen e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

8.4 Detyrimet e çdo ortaku kundrejt shoqërisë përballohen deri në vlerën e papaguar të kapitalit të nënshkruar. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortaku nuk mban përgjegjësi.

## **NENI 9** **TRANSFERIMI DHE SHITJA E KUOTAVE**

- 9.1 Pjesëmarrja e ortakëve në shoqëri përputhet me pjesët e tyre në kapitalin e shoqërisë.
- 9.2 Transferimi dhe shitja e kuotave ndaj të tretëve mund të bëhet pasi më parë kuotat i janë ofruar për blerje ortakëve të tjera dhe këta kanë refuzuar blerjen. Realizimi i tyre bëhet në formë të shkruar dhe një kopje e këtij akti duhet te depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 9.3 Transferimi i kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 73, 74, 75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Kuotat prej 1 (një) lekë janë të pandashme.

## **NENI 10** **ZMADHIMI/ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakëve dhe në përputhje me legjislacionin.
- 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjestim të drejtë me kuotat që posedojnë, mund të përbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve, duke zbatuar kërkesat e legjislacionit fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve.
- 10.3 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu me anë të nënshkrimit dhe pagimit të kuotave të reja të kapitalit nga Ortakët e rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me Vendim te Asamblesë së Ortakëve.

## **NENI 11** **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë janë:

- i) **Asambleja e Përgjithshme**, e cila në momentin e themelimit të shoqërisë dhe deri në pranimin e ortakëvë të rinj përbëhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- ii) **Administratori**.

**NENI 12**  
**KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

- 12.1 Vendimet kryesore lidhur me aktivitetin e Shoqërisë merren nga Asambleja e Ortakëve, i cili është organi më i lartë drejtues i Shoqërisë .
- 12.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të bëhet nga Administratori, ose Ortakët që përfaqësojnë mbi 5% të kapitalit themeltar, me postë të regjistruar ose postë elektronike të paktën (shtatë) ditë përpara. Njoftimi në cdo rast duhet të përmbajë të dhënrat si : data, ora, vendi, rendin e ditës me cështjet që do të shqyrtohen. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpermjet video-konferencës. Për aq kohë sa Shoqëria ka vetëm një ortak dhe nëse vendoset kështu nga Ortaku i Vetëm, ky i fundit mund të heqë dorë nga formalitetet për thirrjen e mbledhjes dhe vendimet e asamblesë së përgjithshme mund të merren në një formë të shkruar nënshkruar nga Ortaku i Vetëm dhe nuk kërkohet të mbahet asnje procesverbal. Në rastet kur nevojitet një vendim urgjent, një miratim paraprak elektronik (me e-mail) i Ortakut të Vetëm mund të paraprije vendimin me shkrim të Ortakut të Vetëm, i cili hartohet më vonë dhe regjistrohet në Regjistrin e Vendimeve të Shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme ushtron të gjitha kompetencat që i janë caktuar në bazë të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Konkrektisht, Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:

- a) modifikimet e këtij Statuti;
- b) pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit të regjistruar ose transferimit të kuotave);
- c) të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
- d) vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidimin dhe çdo Iloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
- e) të themelojë dhe/ose të mbyllë degë ose zyra përfaqësimi;
- f) të vendosë për përvetësimin dhe/ose në transferimin e kuotave të Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj;
- g) të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare nga administratori(ët) dhe nga çdo organ tjetër në Shoqëri;
- h) të miratojë pasqyrat financiare dhe bilancin vjetor, të përcaktojë buxhetin vjetor dhe të miratojë shpërndarjen e fitimeve dhe/ose përbalfimin e humbjeve;
- i) të emërojë ose shkarkojë administratorin (ët);
- j) të miratojë rregullat e brendshme të administrimit;
- k) të ngrejë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- l) të përcaktojë pagën dhe shpërblimet e administratorit(ëve);

- m) të vendosë për emërimin e audituesit ligjor;
- n) të përcaktojë organizimin administrativ dhe strukturor të Shoqërisë ;
- o) te vendosë për çdo çështje tjeter zgjidhja e së cilës është në konpetencën e ortakëve sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe/ose sipas këtij Statuti.

12.4 Marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me veprimtarinë e këtij organi vendimmarrës, hartohen dhe mbahen siç parashikohet në legjislacionin tregtar shqiptarë.

12.5 Pjesëmarja e nevojshme e ortakëve për të arritur në vendimmarrje, e të tjera në lidhje me vendimarrjen, bëhen siç përcaktohet në nenet 86, 87, 88, 89 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

## **NENI 13 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

13.1 Shoqëria administrohet nga Administratori i shoqërisë. Administratori emërohet në detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje nga Asambleja e e Ortakeve.

13.2 Administratori ka të drejtën e administrimit të zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe do të miratojë të gjitha vendimet që ai mund t'i konsiderojë të përshtatshme për të arritur dhe zbatuar objektin e shoqërisë, si dhe do të përfaqësojë individualisht Shoqërinë gjatë veprimtarisë të saj tregtare të përditshme dhe të zakonshme, përveç veprimeve ose çështjeve të rezervuara ose për tu kryer bashkërisht me një person ose organ tjeter në përputhje me këtë Statut ose vendimet e Ortakut të Vetëm të miratuara kohë pas kohe.

Përveçse kur një çështje i rezervohet Ortakut të Vetëm sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij Statuti, Administratori do të ketë kompetenca individualisht për aktivitetet e mëposhtme:

- a) Të administrojë biznesin e përditshëm të Shoqërisë në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Ortakut të Vetëm;
- b) Të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt palëve të treta, pranë çdo institucioni publik e privat, të ndërmarrë veprime gjyqësore e transaksione të ndryshme;
- c) Të hapë/mbylli llogaritë bankare të Shoqërisë, të veprojë pranë çdo banke duke kryer depozitim/derdhje shumash në llogari, térheqje dhe transferta. Kjo e drejtë mund të kufizohet nga Asambleja e Përgjithshme me Vendim te Posacëm;
- d) Të lidhë marrëveshje dhe kryejë transaksione me palë të treta;
- e) Të lëshojë fatura, kërkojë ose kryejë pagesa dhe pranojë letra me vlerë nga palët e treta;

- f) Të punësojë dhe shkarkojë stafin e Shoqërisë dhe përcaktojë pagat, përfitimet dhe shpërblimet e tyre;
- g) Të mbajë librat e kontabilitetit siç përcaktohet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit;
- h) Të përgatisë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë dhe të kryejë auditimin e tyre nga auditues të jashtëm nëse kërcohët nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm;
- i) Të kryejë veprime të tjera në lidhje me veprimitarë e zakonshme tregtare të Shoqërisë;
- j) Administratori mund të delegojë pjesërisht të drejtat e tij tek një palë e tretë, duke përcaktuar kompetencat e tyre, duke respektuar statutin dhe ligjet në fuqi, me autorizim të vulosur me vulën e Shoqërisë (autorizim specifik);
- k) Administratori do të ketë mandat për një periudhë që nuk i kalon 5 (pesë) vjet, mandati i tij mund të rinovohet, përveç nëse revokohet dhe zëvendësohet më herët për çdo shkak me vendim të Ortakut të Vetëm. Revokimi i Administratorit me vendim të Ortakut të Vetëm nuk do të interpretohet si një zgjidhje automatike e kontratës së tij nga Shoqëria, njoftimet përkatëse të kontratës, afatet kohore dhe shpërblimet e parashikuara në këto kontrata, nëse ka, duhet të respektohen dhe të përbëjnë shpërblim të drejtë dhe të plotë për çdo pretendim të Administratorit;
- l) Administratori do t'i raportojë Ortakut të Vetëm;
- m) Administratori ushtron kompetencat duke respektuar ligjin "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare" i ndryshuar dhe konkretisht kapitullin "Mbi administrimin", në nenet 31 e vijues të tij.

13.3 Administratori i shoqërisë, i emëruar për herë të parë, është shtetas:

- **Lediona Kamberi**, lindur më 08.04.1989 në Tepelenë dhe banuese në adresën: *Rrugë "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Tirana*, shtetase shqiptare, identifikuar me leternjoftimin me nr.personal I95408033J, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## NENI 14 MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të drejtat e punëmarrësit, ndërsa të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e shoqërisë dhe rregullat e brendëshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë shoqërisë nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.



**NENI 15**  
**KONFIDENCIALITETI**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e të gjitha informacioneve, akteve dhe dokumentave që janë siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë.

**NENI 16**  
**AUDITUES/(ËT) LIGJOR**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit dhe Asamblesë së Përgjithshme, si dhe gjithë aktiviteti i shoqërisë, i besohet një ose disa auditues ligjor të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme në rast se konsiderohet e nevojshme. Asambleja cakton edhe shpërblimin përkatës, në mungesë të normave të veçanta ligjore mbi pagesën apo shpërblimin e audituesi ligjor.

**NENI 17**  
**BILANCI DHE FITIMET**

17.1 Viti financiar i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik aktual, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Vendimin për miratimin e pasqyrave financiare (bilancit) e merr Asambleja e Përgjithshme.

17.2 Librat e kontabilitetit duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të tjera në vaïutë të huaj, shuma të cilave duhet të konvertohen në monedhën vendase.

17.3 Pasi paguhen detyrimet tativore dhe veçohen fondet për zhvillimin e aktivitetit (sipas planit te buxhetit), të ardhurat që mbeten mund të ndahan mes ortakëve të shoqërisë dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit, sipas dispozitave përkatëse ligjore.



**NENI 18**  
**MOSMARRËVESHJET MES ORTAKËVE**

- 18.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes ortakëve të shoqërisë, ose mes tyre dhe shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet tyre.
- 18.2 Nëse nuk arrihet zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, gjykatë kompetente për zgjidhjen e konfliktit do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 19**  
**SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Në rast se shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsy, Asambleja e Përgjithshme përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidatorë dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për ç'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit. Dispozitat e ligjit mbi shoqëritë tregtare janë të zbatushme.

**NENI 20**  
**DISPOZITË E FUNDIT**

- 20.1 Përsa është shprehur në këtë statut, i është referuar ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, gjejnë zbatim dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 20.3 Çdo ndryshim i dispozitave të këtij statuti bëhet në të njëjtën mënyrë siç është miratuar ky Statut.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Investments & Business Solutions AL"**

